

KONTRATË SHITJE
TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË
BROTHERS MINING MINERALS SHPK

Sot me date 19/11/2021 (dymije e njezet e nje) ,

Z. Jetmir Hasa, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 10.06.1979, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes identiteti me Nr. Personal Leternjoftimi H90610108Q

(Ketu e meposhte referuar si **“Shitesi”**)

Z. Urim Gjoka, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 09/04/1978, dhe banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me Nr.Personal Leternjoftimi H80409049L;

(Ketu e meposhte referuar si **“Bleresi”**)

Shitesi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si **“Palët”**.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Kontratë te Shitjes së kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

DEKLARIME PARAPRAKE:

- Shitesi zotëron 100 % të kapitalit me një vlerë totale prej 100 (njeqind) Lekë të shoqërisë “Brothers Mining Minerals ” sh.p.k, me Nr. N.I.P.T: L71428038E , (këtu e mëposhtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1** Me anë të kësaj kontrate Shitesi i transferon Blerësit me anë të shitblerjes, 100 % te kuotave kapitalit te shoqerise, me nje vlere te pergjithshme prej 100 (njeqind) Leke



- 1.2 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.
- 1.3 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi është kryer përkundrejt çmimit prej 100 (njqind) Lekë.
- 2.2 Palët deklarojnë se çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 3

Kalimi i Pronësisë

- 3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet zotërues të 100 % të kuotave kapitalit të Shoqërisë, duke u bërë titullar të të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me to, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë.
- 3.2 Blerësi Urim Gjoka do të jetë administratori i shoqërisë.

Neni 4

Garancitë

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.



Neni 5
Forca Madhore

- 5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit faktor dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmbytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qendror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

Neni 6
Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

Neni 7
Legjislacioni i zbatueshem

- 7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarreveshjeve

- 8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles së Parë Tiranë Shqipëri.

Neni 9
Shpenzimet

- 9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.

Neni 10



Ndryshimet

- 10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

Neni 11

Hyrja ne fuqi

- 11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

Neni 12

Gjuha e kontratës

- 12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.
12.2 Kontrata e shitjes u redaktua ne baze te nenit 705 e vijusa te Kodit Civil .

PALET

SHITËSI

Yehmi HASA

[Signature]



BLERËSI

Ujir Gjokori
[Signature]